3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër  
(Pas procesit të ankimit)

---

**Shtojca 1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

**a)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

**b)** Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

**c)** Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

**d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

---

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
	<b>Përshkrimi</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njesi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					



<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shënim:** Sasitë e kërkuara nga AK, janë sasi të pritshme, e llogaritur në bazë të cmimit mesatar për litër nëpërmjet studimit të tregut. Kjo sasi mund të jetë e ndryshueshme në varësi të cmimit të publikuar nga APP në buletin javor.

Do të jetë AK ajo që do të përcaktojë sasitë përkatëse gjatë zbatimit të kontratës

**Fondi total i Marreveshjes kuader është :** 39 762 340 (tridhjetenentemilion e shtatëqindëgjashtëdhjetëdymije e treqindëdetyzete) leke ( pa TVSH) .

- Naftë, Euro Diesel D1 (Gazoil 10 ppm)  $\approx$ 202.000 litra, fondi limit total 33 162 340 lekë, pa TVSH.
- Benzinë pa plumb (95 oktan)  $\approx$  40.000 litra, fondi limit total 6 600 000 lekë, pa TVSH.

**Elementët e ofertës do të shprehen në vlerë absolute duke detajuar të gjithë zërat e ofertës dhe vlerat përkatëse:**

1. Cmimi sipas buletinit javor të publikuar nga APP, (cmimet e bursës ndërkombëtare, taksat dhe tarifatat sipas legjislacionit përkatës) leke per liter
2. Vlera e fitimit të shprehur në vlerë absolute, (cmimin e fituar leke për liter), i cili do te jete i pa ndryshuar gjate gjithë periudhes se zbatimit te Marreveshjes kuader.
3. Sasia per liter
4. Vlera totale

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

## Shtojca 5.

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

#### **Parametrat teknike, Specifikimet, Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Për të plotësuar nevojat e DPPGJ -së për vitin 2022 me karburant për automjetet e saj, kërkohet blerja e lëndës djegëse të lëngët për automjete “ Naftë/Euro Diesel D1 dhe Benzinë pa Plumb, sipas specifikimeve teknike të mëposhtme dhe sasi te pritshme per 12 muaj si vijon: Naftë, Euro Diesel D1 (Gazoil 10 ppm) ≈202.000 litra dhe Benzinë pa plumb (95 oktan) ≈ 40.000 litra.

Të dhënat teknike të karburanteve të jenë të standarteve europiane (EN) të karburanteve të adaptuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standarteve dhe që kanë statusin Shqiptar (S SH):

Karburanti qe është objekt prokurimi duhet të jetë Euro –Diesel D1 (Gazoil 10 ppm) dhe Benzinë pa Plumb (95 Oktan). Lëndët djegëse lëngët për automjete - S SH EN Diesel - Kërkesat dhe 590:2013 + A1:2017 Metodat e provës ICS 75.160.20 Miratuar në Komitetin Teknik 19 Ratifikuar me dt. 22.11.2013 Ky standard është i njëjtë me Standardin Evropian EN 590:2013 dhe ka statusin e Standardit Shqiptar. Ky Standard Evropian u miratua nga CEN më 26 Korrik. Anëtarët e CEN-it janë të detyruar të zbatojnë Rregulloret e Brëndshme të CEN/CENELEC, të cilat përcaktojnë kushtet sipas të cilave këtij Standardi Evropian duhet t’i jepet statusi i një standardi kombëtar pa i bërë asnjë ndryshim. Për sa u përket devijimeve dhe rekomandimeve bibliografike të deritanishme për standarde kombëtare të tilla, mund të merren për zbatim vetëm nga Sekretariati Qendror ose nga njeri prej anëtarëve të CEN-it. Ky Standard Evropian ekziston në tre versione zyrtare (anglisht, frëngjisht, gjermanisht). Një version në çfarëdo lloj gjuhe tjetër bëhet nëpërmjet përkthimit nën përgjegjësinë e një anëtari

---

të CEN-it në gjuhën e vet dhe njoftohet Sekretariati Qendror për të patur statusin e njëjtë me atë të versioneve zyrtare. Anëtarët e CEN-it janë organizmat kombëtare të standardizimit të: Austrisë, Belgjikës, Qipros, Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Islandës, Irlandës, Italisë, Letonisë, Lituanisë, Luksemburgut, Maltës, Hollandës, Norvegjisë, Polonisë, Portugalisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Spanjës, Suedisë, Zvicrës dhe Mbretërisë së Bashkuar.

Furnizimi me karburant do të bëhet me kartë elektronike. Kjo sipas kërkesës së Autoritetit kontraktor. Shitësi i karburantit duhet të pajisë Autoritetin Kontraktor me kartë elektronike të personalizuar me targën e cdo automjeti që do të kërkohet. Kartat elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri në përfundimin e plotë të sasisë së karburantit të blerë. Ofertuesit duhet të sjellin fletë-analizat e furnizimeve që të kenë të shprehura karakteristikat e mësipërme për karburantet.

Pikat e karburantit të furnizojnë 24 orë pa ndërprerje.

Fatura tatimore e shitjes e lëshuar nga operatori ekonomik duhet të shoqërohet me:

- Raport analizimi Tregu i brendshëm nga laboratorit i kontrollit të Naftës dhe Gazoilit
- Strukturën e llogaritjes së çmimit për litër
- Kursin e këmbimit valutor të Bankës së Shqipërisë të ditës kur lëshohet fatura tatimore.

Duhet të ketë stacione të tregtimit me pakicë të karburantit të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale qeraje, akt pronësie ose të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së). Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhet të jenë të pajisur me **Leje mjedisore të tipit B** lëshuar nga QKB, Vërtetim teknik i lëshuar nga ISHTI ose Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK) dhe Siguricion ndaj të tretëve për distributorët e shitjes me pakicë të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë në datën e hapjes së ofertave.

Ofertuesi duhet të marrë përsipër dhe garantojë gjithçka sa më sipër të cilësojë, vendndodhjet dhe adresat e sakta të tyre, numrat e telefonit dhe personi i kontaktit. Informacioni për pikat e furnizimit Kartat Elektronike do të përmbajnë emrin tregëtar të shoqërisë/ve kontraktuese, si dhe do të jenë pa afat skadence.

Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vetë Autoriteti kontraktor. Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike stikera (pulla), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar lëvizjen e mundshme të targave nga mjetet shtetërore drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të emailit për cdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit të saj.

**Specifikimet Teknike për nevojat e DPPGJ për Karburant Euro Diesel D1 (Gazoil 10 ppm); Benzinë pa plumb (95 oktan)**

**Të dhënat teknike të Euro Diesel D1 GAZOIL (10 ppm) i referohen standardit. SSH EN 590:2013+A1:2017.**

**Tabela 1**-kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provës për karburantet automotive

Substanca	Njësia matëse	Limitet (normat)		Metoda e provës (shih klauzolës 2)
		Minimum	Maksimumi	
Numri i Cetanit		51	-	EN ISO 5165 EN 15195 EN 16144
Indeksi Cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 gradë celsius	Kg/m <sup>3</sup>	820,0	845,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarbure Polycyclic aromatike	% (m/m)	-	8,0	EN 12916
Përmbajtje squfuri	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884 EN ISO 13032
Përmbajtje Mangani Deri 31-12-2013 Nga 01.01.2014 në vazhdim	mg/l	- -	6,0 2,0	Pr EN 16576
Pika e ndezjes	Gradë celsius	Mbi 55	-	EN ISO 2719
Karboni i mbetur (në 10% mbetje distilati)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Kontaminimi total	mg/kg	-	24	EN 12662
Gërryerja e shiritit bakrit (3 orë në 50 gradë celsius)	Grada	Grupi 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e Acidit të ngopur metil ester FAME	% (V/V)	-	7,0	EN 14078
Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m <sup>3</sup> h	- 20	25 -	EN ISO 12205 EN 15751
Lubrikikimi, diametri i veshjes së mprehte (wsd 1,4) në 60 gradë Celsius	µm (micrometer)	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 gradë Celsius	Mm <sup>2</sup> /s	2,000	4,500	EN ISO 3104
Distilimi % (V/V) rafinimi në 250 gradë celsius	% (V/V)	85	Më pak se 65	EN ISO 3405 EN ISO 3924
% (V/V) rafinimi në 300 gradë Celsius	% (V/V)		360	
95 % (V/V) rafinimi në	Gradë celsius			

Shënim: Kërkesat me Bold i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70 /EC (1), duke përfshirë amendamentet 2003/17/EC (2), 2009/30/EC (3) dhe 2011/63/EU (4).

- a. Shih gjithashtu 5.7.1.
- b. Shih gjithashtu 5.7.4.
- c. Shih gjithashtu 5.7.2.
- d. Për qëllimet e këtij Standardi Evropian, hidrokarbonet policiklikë aromatikë janë caktuar si përmbajtja totale e hidrokarboneve aromatike më pak se përmbajtja e hidrokarboneve monoaromatike, të dyja të përcaktuara në EN 12916.
- e. Shih gjithashtu 5.7.3.
- f. Shih gjithashtu 5.2.2.
- g. Shih gjithashtu 5.2.2. dhe Aneksi A.
- h. Investigimi i mëtejshëm për kontaminimin total në metodën e provës për përmirësimin e saktësisë, veçanërisht për prezencën e FAME, nën mbikëqyrjen e CEN.
- i. FAME i përkojnë kërkesat e EN 14214, shih (3).
- j. Kur karburantet e naftës përmbajnë më shumë se 2 % (V/V) FAME, qëndrueshmëria e oksidimit e përcaktuar në EN 15751 është kërkesa për të.
- k. Për llogaritjen e indeksit të Cetanit 10%, 50 % dhe 90% (V/V) nevojiten gjithashtu pikat e RECOVERY.
- l. Limitet e distilimit në 250 gradë Celsius dhe 350 gradë Celsius janë përfshirë në tarifën e karburantit naftë të Doganave të përbashkëta të BE.
- m. EN ISO 3924 jep instruksione për konvertimin në ISO 3405-të dhëna ekuivalente. Shih gjithashtu 5.7.5.

**Në vijim, Tabela 2- Kërkesa dhe metoda testi për benzinën pa plumb me përmbajtje oksigjeni maksimum prej 2.7% (m/m)**

**Të dhënat teknike të Benznë pa plumb (95 oktan) i referohen standardit. EN 228:2012+A1:2017.**

Vetitë	Njësitë	Kufizimet		Metoda Testi <sup>a</sup> (Shih 2. Referenca normative)
		Min	Max	
Numër Oktani Kërkimi, RON		95,0		EN ISO 5164 b
Numër Oktani Makine, MON		85,0		EN ISO 5163 b
Përmbajtje plumbi	Mg/l		5,0	EN 237
Densiteti (në 15°C) c	Kg/m <sup>3</sup>	720,0	775,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Përmbajtje Sulfuri c	Mg/kg		10,0	EN ISO 13032 EN ISO 20846 EN ISO 20884
Përmbajtje manganazi d Deri 31-12-2013 Nga 01-01-2014	Mg/l		6,0 2,0	EN 16135 EN 16136
Qëndrueshmëria e oksidimit e	Min.	360		EN ISO 7536
Përmbajtja e gomës ekzistente (solvent i larë)	Mg/100ml		5	EN ISO 6246
Rrip korrozioni bakri 3 h në 50 °C	Vlerësim	Klasi 1		EN ISO 2160
Dukshmëria e		I qartë dhe i ndritshëm		Inspektim vizual
- Përmbajtja e tipit të hidrokarbonit c - Olefinë - Aromatik	% (V/V)		18,0 35,0	EN 15553 EN ISO 228 54
Përmbajtja e benzolit c	% (V/V)		1,00	EN 238 EN 12177 EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenit c	% (m/m)		2,7	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenatit c  - Methanol - Etanol g	% (V/V)		3,0 5,0	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854
- Alkool Iso-propil h - Alkol Iso-butyl h - Alkool Tert-butyl h			Përzierje volumi e kufizuar në 2.7% (m/m) përmbajtja	



<ul style="list-style-type: none"> <li>- Eterë (5 ose më shumë atome C) h</li> <li>- Oksigjenate të tjera hi</li> </ul>			max. e oksigjenit	
---	--	--	-------------------	--

SHËNIM: Kërkesat e theksuara me **bold** i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4)

- (a) Shih gjithashtu 5.7.1
- (b) një korrektim i 0,2 për MON dhe RON do të zbritet për përlogaritjen e rezultatit final përpara raportimit sipas kërkesës së Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70/EC (1) duke përfshirë amendamentet në vijim (2), (3) dhe (4). Shih gjithashtu 5.6 dhe 5.7.2
- (c) Shih gjithashtu 5.7.2
- (d) Shih gjithashtu 5.3.3
- (e) Dukshmëria do të përcaktohet në temperaturë ambienti
- (f) Do të shtohen agjentë stabilizues
- (g) Kur përdoret etanoli si komponent përzierjeje do të bëhet në përshtatje me EN 15376 (Shih 5.1). Agjentë stabilizues mund të shtohen.
- (h) Përmbajtja e oksigjenit të benzinës së pastër pa plumb nuk do të kapërcej 2,7% (m/m). Një CEN/TR mbi përzierjen oksigjenate është në përgatitje e sipër.
- (i) të tjera monoalkoolike dhe eterë me një pikë zierjeje të fundit jo më të lartë se sa përshkruhet në Tabelën 4

---

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

Sasia e e pritshme e mallit që kërkohet për 12 muaj:

- Naftë, Euro Diesel D1 (Gazoil 10 ppm)  $\approx$ 202.000 litra,
- Benzinë pa plumb (95 oktan)  $\approx$  40.000 litra

**Afatet e lëvrimit: Sipas nevojave dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor per 12 muaj nga data e lidhjes se marreveshjes kuader.**

---

## Shtojca 7

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vleres se parashikuar te marrëveshjes kuadër.

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate të bilanceve të viteve 2018, 2019, dhe 2020 nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

*Kriteri do të konsiderohet i përmbushur edhe në rastet kur operatorët ekonomik zgjedhin të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore si dhe raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, në rastet kur operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, që në fazën e parakualifikimit.*

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit.

**Shenim 2.2.2.1:**

Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

**Shenim 2.2.2.2:**

Detyrimisht sipas përcaktimeve ligjore, kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.2.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39% e vlerës së përlogaritur të marrëveshjes kuadër.

Kjo pikë përmbushet me vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Licencën e Tregëtimit të Karburanteve nga Qendra Kombetare e Licencimit ose Licencën nga Ministria përkatëse që mbulon transportin rrugor, ose me Autorizim të lëshuar nga pushteti vendor për tregtim klarburantesh me pakice, vendore në përputhje me Ligjin Nr.8450 dt. 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nën produkteve të tyre.

2.3.3 Operatori duhet të ketë të pakten 3 ( tre) pika shpërndarje të karburantit ose marrëveshje me ndonjë pikë shpërndarje brenda territorit të Bashkisë Tiranë, ku të jete e përcaktuar adresa e sakte dhe të mos ketë detyrime tatimore. Shërbimi në këtë pikë furnizimi duhet të sigurohet për 24 ore në çdo ditë të javës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e pikave të karburantit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. **Ndërsa operatori ekonomik fitues para lidhjes së kontratës duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:**

<b>Nr.</b>	<b>Pika shpërndarje</b>	<b>Adresa</b>	<b>Statusi</b> Pronesi/qira/perdorim	<b>Detyrime tatimore</b>
1				

2				
3				

\*Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mesiperm prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raport fletë-analizë për produktin Naftë Euro-Diesel D1 10PPM S.SH.EN:590-2013/A1:2017 dhe benzinë pa plumb S.SH.EN:228-2012/A1:2017 lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj duhet përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, që vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që ofertuesi tregton, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike të lëshuara jo më parë se 3 muaj nga data e hapjes se ofertave.

**2.3.5** Subjekti ofertues duhet te zoteroje 2 (dy) automjet teknologjik të llojit AutoBot e vertetuar me akt shitjeblerje ose kontrate qeraje (e cila duhet të zgjasë dhe të mbulojë shërbimin për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës për vitin 2022) shoqeruar me Certifikaten e pronesise, leje qarkullimi, taksat vjetore, siguracion, akt kolaudimi, çertifikaten per transport mallrash te rrezikshëm brenda vendit, çertifikaten e inspektimit, pashaport autoboti, i cili te bëjë të mundur furnizimin e autoritetit kontraktor. Keto dokumenta duhet te jenë brenda afatit të vlefshmerisë se zbatimit te kontrates.

•Automjetet tekonologjike (Auto Bot) nuk duhet te jene me kapacitet me te madh se 20.000 litra qe te kene mundesi hyrje ne ambjentet e magazines.

•Ne rast se eshte marre me qera te paraqese kontraten e qera-marrjes, te shoqeruar me lejen e qarkullimit te qiradhenesit me objektin e prokurimit ne fjale dhe Autoritetin Kontraktor, siguracionin e mjetit, taksat, Certifikaten per transport mallrash te rrezikshme brenda vendit, pashaporten e botit dhe Certifikaten e kontrollit teknik te mjetit.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim
2				Pronesi/qira/perdorim

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mesiperm prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete I pajisur dhe te paraqese certifikatat e leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise,qe kane lidhje me objektin e kontrates, si me poshte:

- Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikatë të cilësisë së punimeve ISO 9001- 2015 (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2015 (e vlefshme).(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007 ose ekuivalent me te ISO 45001:2018 (e vlefshme).

*Ne rastin e bashkimit te operatoreve Certifikatat e mesiperme duhet te paraqiten nga secili OE.*

**2.3.7** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga **ISHTI**, që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standarteve të Legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2021.

**2.3.8** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **20 persona** per periudhen 3 muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. **Ndërsa operatori ekonomik fitues para lidhjes se kontrates duhet te dorezoje dokumentacionin si me poshte:**

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave .
- List pagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes se ofertave.

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Kodi i deklarimit ne Liste Pagese	Data e fillimit te marredhenieve te punes

\*Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale te punes si dhe lejet e drejtimit te cdo punonjesi prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit.

**2.3.9** Deklaratë sipas së cilës merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në qytetin e Tiranës, me kartë elektronike të personalizuar me targën e cdo automjeti të autoritetit kontraktor ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor ne perputhje me VKM Nr 561 date 29.07.2016.

**2.3.10** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se furnizimi i mjeteve do të jetë e mundur të realizohet çdo ditë të javës brenda 24 orëve në të gjithë distributorët e furnizuesit dhe në pistoletë publike. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë ta ketë të nevojshme.

---

**2.3.11.**Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) “Ekspert per mbrojtjen nga zjarri dhe per shpetimin” të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë per 3 (tre) muajt e fundit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e ekspertit, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. **Ndersa operatori ekonomik fitues para lidhjes se kontrates duhet te dorezoje dokumentacionin si me poshte:**

Kontratë pune noteriale të vlefshme, certifikaten e ekspertit, CV, librezë pune, diplomën përkatëse.

\*Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale te punes si dhe lejet e drejtimit te cdo punonjesi prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**



---

**Shtojca 8.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I.Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>	<b>Referencat (kur janë të zbatueshme)</b>
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për</p>	<p>_____</p>

Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;	<b>Po</b> [ ]
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	<b>Po</b> [ ]
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	<b>Po</b> [ ]
